



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 117/2019

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 100/2017 “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21/1 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Grupit Parlamentar Demokrat,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 100/2017 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Deputeti Arlind Çaçani caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

2. Deputeti Korab Lita caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Integrimin European.

3. Deputeti Halil Jakimi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Politikën e Jashtme.

4. Deputeti Alban Zeneli caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

5. Deputeti Halit Valteri caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

6. Deputeti Arben Elezi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 9.10.2019